



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/166  
Datë: 15.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 tetor 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/58 të datës 02.02.2022**

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/58 i datës 02.02.2022 në pikën 1. të Vendimit si vijon:
  - 1.1. Z. Arton Ahmeti, Kryesues;
  - 1.2. Z. Skender Haziri, anëtar.
2. Pikat tjera të Vendimit Nr. 02/58 të datës 02.02.2022 mbesin të pandryshuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/166  
Datë: 15.10.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 tetor 2023, merr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Zgjerimi i Rrugës Rajonale, R 115 Prizren - Prevallë, Zona Kadastrale: Gornje Sellë, Komuna Prizren, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtuesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislacionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/166  
Datë: 15.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 tetor 2023, merr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Zgjerimi i Rrugës Rajonale, R 115 Doganaj-Shtërpcë" Zonat Kadastrale: Viqë dhe Drekok, Komuna Shtërpcë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjisllacionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë